



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1203/23 Datë: 15/09/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më datë 25.08.2023 dhe vazhdimin e mbledhjes së 115-të, të mbajtur me datë 31.08.2023, mori:

### V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën një (1) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2024):
  1. *Infermieri BSc 180 ECTS (R) me kuotën, maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I dhe II, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Pas një viti, Programi Infermieri BSc do t'i nënshtrohet procedurave pasakredituese (follow up), në të cilën nuk do të përfshihen ekspertët që tanimë kanë bërë vlerësimin e këtij programi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik dhe ekspertët si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Infermieri BSc 180 ECTS (R)</i>	Trendelina Pllana Migjena Tasholli Selvete Zyberaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; *Infermieri BSc 180 ECTS (R)* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik, Enkeleint Mechili, Delia Gologan, është organizuar me 25.07.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht gjashtë (6) dhe Pjesërisht një (1) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në vazhdimin e mbledhjes së 115-të, të mbajtur me datë 31.08.2023, ka shqyrtuar raportet finale të ekspertëve në konkluzionin e të cilit rekomandohet që programi *Infermieri BSc 180 ECTS (R)* i Kolegjit UBT kampusi kryesor të akreditohet në kohëzgjatje prej 1 viti dhe me numër të studentëve 100.

Andaj duke u bazuar në të gjeturat në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
  
 Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
 Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë